

POLITIKA MONETARE DHE FISKALE NË NJË MJEDIS TË NDRYSHËM

*Sulo Hadëri**
*Sybi Hida***

ABSTRAKT

Sistemi bankar në Shqipëri gjatë viteve të fundit është transformuar krejtësisht, i drejtuar nga sistemi bankar me pronësi shtetërore në një sistem bankar me pronësi private. Privatizimi i sistemit bankar në Shqipëri si pjesë e paketës së masave të ndërmarra nga politika, kishte për qëllim të fuqizonte sistemin financiar, të pakësonte mundësinë për kriza të ardhshme dhe të rriste eficiencën e ekonomisë. Në të njëjtën kohë, si rrjedhojë e zhvillimit të saj ekonomik, Shqipëria po përgatitet të integrohet tërësisht në ekonominë botërore dhe në tregjet financiare ndërkombëtare. Zhvendosja nga një sistem bankar shtetëror në një sistem bankar privat, pa dyshim që ngre disa çështje rreth funksionimit të këtij sistemi dhe marrëdhënieve midis politikës fiskale dhe asaj monetare. Në këtë material diskutimi, ne do të përpiqemi t'i analizojmë këto çështje dhe të shkojmë më tej në disa shqetësime që politikëbërësit duhet të shqyrtojnë rreth marrëdhënieve të ardhshme midis politikës monetare dhe asaj fiskale.

HYRJJE

Shqipëria në fillimet e transformimit të saj në një ekonomi tregu, trashëgoi një sistem bankar unik, i cili kryente funksionet e një

banke qendrore dhe transaksione tregtare të kufizuara. Politika që Shqipëria zbatoi në fillimet e tranzicionit mund të klasifikohet në një filozofi “Washington consensus”. Në fakt, jo të gjitha reformat strukturore, të zbatuara në Shqipëri, mund të klasifikohen si politika Bing Bag. Politikat e zbatuara në sektorin bankar gjatë dhjetë viteve të tranzicionit mund të klasifikohen si politika të ngadalta.

Reforma bankare në Shqipëri filloi në korrik të vitit 1992, me krijimin e Bankës së Shqipërisë si një bankë e re qendrore, dhe të gjitha operacionet tregtare iu transferuan bankës së re të krijuar, Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Bankës Qendrore iu dha një shkallë pavarësie, që është thelbësore për zbatimin e programit të përgjithshëm të stabilizimit dhe në vitin 1992, për herë të parë në Shqipëri, Banka Qendrore vendosi një kufizim të fortë mbi buxhetin për të kontrolluar rritjen e parasë dhe të kredisë. Në atë kohë, Bankës Qendrore nuk iu dha një shkallë e lartë pavarësie. Duke iu referuar ligjit “Për Bankën e Shqipërisë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës u emëruan nga Presidenti me propozim të Bordit të Bankës Qendrore me një mandat jo më shumë se 5 vjet; nuk kishte dispozita për të siguruar që kredia direkte të ishte në normën e interesit të tregut.

Deri në vitin 1996, kishte shumë pak reforma në sektorin bankar dhe pas krizës së vitit 1997, u miratua një ligj i ri mbi sektorin bankar i cili fuqizonte më tej pavarësinë e Bankës Qendrore dhe filloi një strategji privatizimi. Sipas Maliszewski (2000)³ pavarësia ligjore e Bankës Qendrore u konsiderua e lartë me 12 pikë, pranë asaj të Bundesbank me 13 pikë në indeksin origjinal GMT dhe një pikë shtesë për dispozitat jopolitike mbi kohëzgjatjen e një guvernatori. Indeksi për ligjin e vjetër (1992) i gjetur nga Maliszewski (2000) ishte 10. Prandaj, është e qartë se është bërë mjaft progres në pavarësinë e Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, taveni cilësor mbi kredinë e bankës qendrore (huatë direkte) për qeverinë u ul nga 10 për qind të të ardhurave mesatare të buxhetit për tre vitet e mëparshme në vitin 1996, në 6 për qind në vitin 1997 dhe 5 për qind në vitin 2002, të gjitha me kushtin që norma e interesit të ishte jo më e ulët sesa norma e tregut të bonove të thesarit.

Krijimi i një banke qendrore të pavarur është pjesë e reformave në sektorin bankar. Është pranuar gjerësisht se një treg funksionon

në qoftë se është vendosur infrastruktura ligjore. Në analizën tonë, Shqipëria bëri një hap përpara në krijimin e institucionit të Bankës Qendrore para privatizimit të bankave tregtare. Strategjia e privatizimit të sistemit bankar, e filluar në vitin 1998, përfundoi me sukses në fund të vitit 2004, kur 95 për qind e sektorit bankar i përkiste sektorit privat. Përtej reformave strukturore në sektorin bankar, gjatë këtyre viteve ekonomia shqiptare ndryshoi në mënyrë dramatike. Sot, sektori privat prodhon më shumë se 75 për qind të PBB-së dhe ekonomia është tërësisht e hapur dhe stabiliteti makroekonomik duket i qëndrueshëm. Sigurisht, nga këto përpertime në ekonomi rezultoi që PBB-ja për frymë në vitin 2004 llogaritej rreth 2,500 usd. Në kontekstin e sektorit bankar, privatizimi i këtij sektori dhe huatë e buta do të ngrajnë disa probleme për diskutim. Në këtë material diskutimi ne do të përqijemi të analizojmë efektet e mundshme të privatizimit të sektorit bankar në ekonomi. Në pjesën tjetër të materialit, do të analizojë rrugën e ndjekur nga Shqipëria për financimin e deficitit buxhetor. Në fund të materialit do të ketë disa përfundime dhe rekomandime.

Pse një sistem bankar privat?

Është pranuar në përgjithësi se në një ekonomi tregu, një sektor bankar privat është më i mirë se një sektor bankar shtetëror. Ky përfundim teorik ka gjetur një zbatim të suksesshëm gjatë fundshekullit të kaluar. Numri i privatizimeve të bankave në mbarë botën, që prej mesit të viteve `70, është tregues i asaj se si pronësia shtetërore e bankave ka qenë në disfavorin e shumë politikëbërësve. Ai përfshin mbi 235 privatizime në më shumë se 65 vende (Andrews, 2005). Sistemi që Shqipëria trashëgoi nga ai paraardhës ishte krejtësisht i ndryshëm nga ajo që kërkohej në një sistem të ekonomisë së tregut.

Siç e përmendëm më sipër, privatizimi i sektorit bankar në Shqipëri, pas fuqizimit të Bankës Qendrore, mund të klasifikohet si një politikë e zgjuar. Ne mendojmë se tabloja e krizës së vitit 1997 mund të ishte më e keqe nëse sistemi bankar do të ishte pronë e sektorit privat. Ky mendim bazohet në idenë që bankat, për të mbijetuar, mund të ishin përfshirë në transaksionet e firmave piramidale. Duke patur parasysh se roli i mbikëqyrjes bankare ishte i dobët, bankat mund të kishin qenë pjesë e këtij kaosi financiar. Fatmirësisht, sektori bankar ishte i

pavarur nga firmat piramidale dhe kjo përbënte një pikënisje të mirë për krijimin e një sektori të fuqishëm financiar në Shqipëri. Sigurisht që privatizimi i këtyre bankave tregtare është hapi i parë.

Në studimin e tij me rreth 65 vende mbi lidhjet ndërmjet bankave shtetërore, privatizimeve dhe sektorit bankar, Andrews (2005) theksoi se privatizimi është shpesh pjesë e paketës së masave të politikës, që kanë për qëllim fuqizimin e sistemit financiar, duke pakësuar mundësinë e krizave të ardhshme dhe humbjeve të prodhimit që i shoqërojnë ato. Në materialin e tij të diskutimit, Andrews (2005) është përpjekur t'i përgjigjet pyetjes nëse privatizimi mund të shkaktojë krizë bankare. Vetëm pak shembuj tregojnë se burim i krizave bankare ka qenë privatizimi, veçanërisht në Meksikë dhe në Kili. Sipas Andrews (2005) problemet bazë të sektorit bankar të privatizuar janë: (i) dështimi në përcaktimin e parakushteve për një mbikëqyrje bankare efektive; (ii) mangësitë në kuadrin rregullator dhe në zbatimin e tij; dhe (iii) mungesa e kapitalit dhe aftësitë e papërshtatshme administruese. Përveç këtyre problemeve, një nga përfundimet kryesore të këtij materiali ishte se privatizimi i bankave rrallë shoqërohet me kriza bankare.

Është e rëndësishme që të njëjtat shqetësime të qëndrojnë edhe për sektorin bankar në Shqipëri. Privatizimi i sektorit bankar shqiptar gjatë këtyre viteve e ka ndryshuar krejtësisht strukturën e pronësisë. Në vitin 1998, sektori privat përfshinte më pak se 10 për qind të bankave tregtare dhe sot ai përfshin më shumë se 95 për qind të tyre. Ky ndryshim është shoqëruar me hyrjen në treg të bankave të reja tregtare. Përveç përparimeve të dukshme, vërehen akoma shumë probleme në sektorin bankar.

Sektori financiar në Shqipëri ka njohur panikun e skemave piramidale (2000). Ky është një tipar që kërkon përpjekje të mëtejshme për ta edukuar publikun me funksionimin e bankave tregtare. Banka qendrore duhet të jetë e vëmendshme rreth sinjaleve të gabuara që jepen mbi bankat tregtare, veçanërisht nga politika. Megjithatë, akoma sektori bankar nuk shfaq një konkurrencë të lartë, gjë që është një dobësi tjetër e sektorit bankar në Shqipëri. Jo të gjitha bankat tregtare janë përfshirë në tregun e kredisë, një tipar që kërkon më shumë analizë. Banka qendrore duhet të përfshihet në arsyet e

kësaj sjelljeje si për ato me nivel të lartë të kredisë (huave) ashtu dhe për ato që nuk janë pjesë e këtij tregu. Do të ishte e dobishme për tregun financiar që kjo lloj sjelljeje e bankave tregtare të mos krijojë probleme në të ardhmen.


Një tipar tjetër i sektorit bankar në Shqipëri është se bankat tregtare nuk janë të përfshira në transaksione ekonomike (shumë pak). Është e vështirë të thuash se nga cilat drejtime anon objektivi, nga sektori bankar apo nga sektorët e tjerë. Ky tipar i sistemit bankar në Shqipëri tregon se ndikimi në sektorin bankar është i vogël, gjatë një krize ekonomike - siç ishte ajo e vitit 1997. Përveç këtij ndikimi “pozitiv”, sektori bankar duhet të përfshihet në transaksionet ekonomike dhe presionet duhet të vijnë nga të gjithë aktorët (banka qendrore, qeveria, sektori privat etj.). Përfshirja e sistemit bankar në këto transaksione do të ketë një ndikim të rëndësishëm në perceptimin e sektorit financiar nga publiku.

Pavarësisht nga hapat e mëtejshëm që duhen ndërmarrë në sektorin bankar, përparimi është i dukshëm. Niveli i kredidhënies në ekonomi është rritur mjaft nga 4.3 për qind e PBB-së në vitin 1998, në 8.4 për qind e PBB-së në vitin 2004. Vlen të përmendet se privatizimi i bankës më të madhe në Shqipëri - Bankës së Kursimeve - është realizuar kohët e fundit. Ky privatizim do të ndikojë pozitivisht në tregun financiar, nëpërmjet rritjes së konkurrencës. Përvoja tregon se sistemi bankar do të jetë më efektiv në të ardhmen. Tani është pothuajse i privatizuar. Përvoja e Shqipërisë dhe ajo e vendeve të tjera tregojnë se bankat qendrore duhet të rrisin aftësinë e autoritetit mbikëqyrës.


Privatizimi i bankave: Financimi i deficitit buxhetor.

Në një ekonomi tregu, pranohet gjerësisht se qeveria funksionon nëpërmjet deficitit buxhetor - ajo më shumë shpenzon sesa arkëton. Mbetja e parave që qeveria shpenzon vjen nga huamarrja. Qeveria është e lirë të marrë hua nga sektori financiar. Edhe Qeveria Shqiptare operon me këtë filozofi ekonomike. Nga viti 1993 deri në vitin 2000, përqindja e huamarrjes në financimin e shpenzimeve publike ka qenë rreth 20 për qind, për periudhën 2000–2004 rreth 16 për qind dhe

bazuar në parashikimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për periudhën 2005-2009 ajo do të jetë rreth 15 për qind (shih grafikun 1).



Qeveria ka marrë hua si nga tregu i brendshëm ashtu dhe nga tregu ndërkombëtar. Tregu ndërkombëtar për Qeverinë Shqiptare gjatë këtyre viteve, tregon marrjen hua nga institucione ndërkombëtare si Banka Botërore - me hua të buta. Qeveria Shqiptare më shumë është mbështetur në tregun e brendshëm. Shumicën e kohës përqindja e huamarrjes së brendshme në totalin e huamarrjes, ka qenë më e madhe se 60 për qind (shih grafikun 2). Sipas Programit Afatmesëm



të Buxhetit 2005-2007 dhe parashikimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, struktura e huamarrjes së qeverisë do të jetë në favor të huamarrjes së brendshme, duke arritur vlerën 65 për qind në vitin 2009.


Sipas teorisë standarde të ekonomisë neoklasike, vendet me mungesë të kapitalit duhet të marrin hua në shuma të mëdha për të financuar investimet e brendshme. Shqipëria, si një vend që ka trashëguar një nivel të lartë të varfërisë dhe një infrastrukturë të keqe, është detyruar të mbështetet, për një periudhë të gjatë kohe, në huamarrjen për të financuar kërkesën shumë të lartë për investime publike. Nevoja për huamarrje dhe ndryshimi i mjedisit në të cilin ka vepruar Qeveria Shqiptare deri tani, ngre shqetësime rreth financimit të ardhshëm të deficitit buxhetor. Në themi mjedis të ndryshëm pasi sot sistemi bankar është privatizuar tërësisht dhe ekonomia shqiptare nuk klasifikohet më si një vend me zhvillim të ulët, për të përfituar nga huatë e buta të institucioneve ndërkombëtare. Në këto rrethana, mundësitë e Qeverisë Shqiptare janë që ajo të përgatitet për të marrë hua në tregun ndërkombëtar dhe të jetë e kujdesshme në tregun vendas.

Përveç këtij mjedisi të ndryshëm në të cilin qeveria do të veprojë, situata makroekonomike është e favorshme. Ekonomia shqiptare gjatë viteve të fundit ka patur një normë të lartë rritjeje ekonomike dhe kjo normë pritet të mbahet edhe për një periudhë të gjatë në të ardhmen. Kjo rritje ekonomike pritet të shoqërohet me një situatë të qëndrueshme makroekonomike, me një inflacion të ulët dhe me një normë të qëndrueshme të kursit të këmbimit. Gjatë këtyre viteve janë marrë masa për përmirësimin e financave publike, që do të ndikojnë në fuqizimin e administrimit të shpenzimeve publike. Gjithashtu, për një periudhë të gjatë kohe në të ardhmen, fluksi i remitancave nga emigrantët do të qëndrojë në një nivel të lartë dhe rezervat zyrtare pritet të qëndrojnë po në nivel të lartë. Si gjithmonë, ka shenja pasigurie. Është e vështirë të parashikohet drejtimi i deficitit buxhetor – në fakt supozohet se do të qëndrojë në nivele të ulëta (i vlerësuar gjithashtu nga FMN). Sjellja e normave të interesit është gjithashtu, një faktor i rëndësishëm që duhet marrë parasysh. Megjithatë, rastet që duhen shqyrtuar do të varen nga situata makroekonomike – që duket se është stabilizuar. Nga përvoja e ekonomisë shqiptare,

është e vështirë të parashikohet ndikimi i paqëndrueshmërisë dhe i tronditjeve të jashtme të qëndrueshmërisë fiskale. Gjithsesi, këta faktorë duhet të përbëjnë shqetësim për politikëbërësit në Shqipëri.


Një tipar tjetër i ekonomisë shqiptare është se niveli borxhit mund të konsiderohet në një pozicion të fortë. Norma e borxhit publik në vitin 2004, llogaritet më e ulët se 55 për qind e PBB-së, ndërsa në 15 vendet e Bashkimit Evropian ajo llogaritet mesatarisht 63.2 për qind e PBB-së. Pjesa më e madhe e borxhit publik në Shqipëri i takon borxhit të brendshëm, në 35 për qind të PBB-së në vitin 2004 dhe 20 për qind e PBB-së i përket borxhit të jashtëm. Synimi i huamarrjes nga publiku, e brendshme apo e jashtme, është i njëjtë – të shpërndajë shërbime publike, por faktorë të ndryshëm ndikojnë në sjelljen e huamarrjes së brendshme dhe të jashtme në mënyra dhe përfshirje të ndryshme. Privatizimi i bankave tregtare është kryesisht i lidhur me huamarrjen e brendshme dhe huatë e brendshme janë të lidhura me huamarrjen e jashtme.

Niveli i borxhit të brendshëm në fund të vitit 2004 arriti në 295 miliardë lekë ose 35 për qind e PBB-së dhe, sipas vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (dhjetor 2004), në vitin 2008 ai do të arrijë në 427 miliardë lekë. Duket sikur tregu i brendshëm financiar do të përballë me një kërkesë të lartë të qeverisë për huamarrje, gjatë katër viteve të ardhshme. Është e rëndësishme që njëkohësisht qeveria të ndërmarrë disa veprime për të përcaktuar disa probleme



me të cilat përballet tregu vendas. Pjekuria e tregut vendas është e vogël, gjë që do të pengojë harmonizimin e politikës monetare me atë fiskale. Gjithashtu, borxhi i brendshëm është tepër i përqendruar (shih grafikun 3), kur 45 për qind e borxhit të brendshëm i përket bankës “Raffaissen”.

Sipas borxhit të jashtëm, ekonomia shqiptare përsëri shfaqet në një pozitë të fortë; niveli i borxhit të jashtëm publik është rreth 20 për qind të PBB-së, dhe kjo përqindje ka rënë gjatë viteve të fundit. Përveç sektorit publik, statistikat tregojnë se sektori privat nuk ka marrë hua nga tregu ndërkombëtar ose kjo përqindje është shumë e ulët. Kjo është një shenjë tjetër e mirë e pozicionit të jashtëm. Struktura e borxhit të jashtëm publik është afatgjatë dhe e zotëruar kryesisht nga donatorë shumëpalësh. Përfitimi i huave të buta nga organizatat ndërkombëtare dhe niveli i borxhit të jashtëm ka qenë i ulët, sepse pjesa më e madhe e borxhit i përket një periudhe 10-vjeçare (periudha që një huamarrës është i lirë të paguajë borxhin).



Një tipar tjetër i borxhit të jashtëm, me të cilin Qeveria Shqiptare do të përballet në të ardhmen e afërt, është që ajo do ta humbasë të drejtën e përfitimit nga huatë e buta. Kjo do të thotë që qeveria duhet të gjejë burime të tjera për të financuar shërbimet publike. Qeveria Shqiptare duhet të bashkëpunojë me bankat tregtare ose duhet të marrë hua nga tregu financiar. Burimet e financimit do të jenë më

të shtrenjta sesa ato me të cilat qeveria ka vepruar deri tani. Përveç kostos së huave, Qeveria Shqiptare duhet të mbulojë disa detyrime të tjera, në mënyrë që të marrë pjesë në tregun financiar. Kushti i parë për të shkuar drejt tregut financiar është vlerësimi i klasifikimit të kredisë së Shqipërisë. Klasifikimi i kredisë është një hap i rëndësishëm që Shqipëria duhet të ndërmarrë dhe vendimi për të duhet të jetë shumë i kujdesshëm. Do të ishte pozitive për Shqipërinë nëse koha e vlerësimit do të përputhej me praninë e një mjedisi të favorshëm ekonomik të brendshëm dhe rajonal. Në deklaratën e tij të datës 18 janar 2005, zëdhënësi presidencial Filipino “ky klasifikim i kredisë [çrregullimi i klasifikimit të kredisë RP nga Standard & Poor’s] na gjeti në kulmin e reformave urgjente dhe ne kemi besim që do të ndryshojë me pranimin e plotë të programit tonë fiskal. ... ne kemi besim që S & P do ta rishikojë vlerësimin tonë dhe do të shqyrtojë klasifikimin tonë, sapo të jenë kuptuar plotësisht arritjet e mëdha të qeverisë...”. Është e qartë se vlerësimi i parë i normës së kredidhënies do të ndikojë në koston e borxhit të jashtëm publik. Derisa Shqipëria të ketë një klasifikim të kredisë, bankat tregtare duhet të jenë një burim huamarrjeje.

Sipas MTBP 2005-2007 dhe vlerësimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, niveli i borxhit të jashtëm në vitin 2009 do të jetë pothuajse i njëjtë me nivelin e huamarrjes së jashtme të re (shih grafikun 4). Kjo do të thotë që fluksi neto i parasë në ekonomi do të jetë pothuajse zero. Do të jetë në interesin e Qeverisë Shqiptare të përfshihet në sa më shumë punë kërkimore mbi këtë çështje si dhe të vlerësojë ndikimin mbi qëndrueshmërinë fiskale. Pa dyshim, që duhet të ndërtohen skenarët e ndryshëm me nivele të ndryshëm interesi, inflacioni, si dhe rritja ekonomike e ndryshme mbi qëndrueshmërinë fiskale për t’i paraprirë çdo lloj rasti.

Përfundime dhe rekomandime

Përfundimi kryesor që mund të nxjerrim nga ky material diskutimi është se nevojiten kërkime të mëtejshme dhe më të thella mbi këtë çështje, për t’u dhënë këshillën e duhur politikëbërësve. Megjithatë, ne mund të themi se sistemi bankar në Shqipëri është në rrugën e duhur. Koha e privatizimit të sistemit bankar mund të cilësohet si një

politikë e zgjuar. Ai është bërë pas krijimit të organit rregullator dhe mbikëqyrës - bankës qendrore.

Përveç performancës së mirë të sektorit bankar në Shqipëri, fuqizimi i aftësisë së autoritetit mbikëqyrës të sistemit bankar duhet të shqyrtohet seriozisht nga banka qendrore.

Niveli i borxhit publik të Shqipërisë është në pozitat e duhura, por është e nevojshme ndërmarrja e disa veprimeve për rregullimin e strukturës së tij. Do të jetë e nevojshme që qeveria të marrë masa për të përmirësuar administrimin e huamarrjes së brendshme. Maturimi i shkurtër dhe përqendrimi i borxhit të brendshëm mund të rrisin problemin e likuiditetit. Është e nevojshme të zgjerohet struktura e borxhit të brendshëm dhe të zbatohen politika që përfshijnë individët në blerjen e borxhit të brendshëm. Gjithashtu, sipas rritjes së konkurrencës në tregun e brendshëm financiar (privatizimi i bankave), Ministria e Financave duhet të përmirësojë operacionet e thesarit dhe të administrimit të borxhit.

Është e qartë se Shqipëria e ka humbur të drejtën e përfitimit nga huatë e buta, dhe duhet të përgatitet për t'u përfshirë në tregun ndërkombëtar financiar. Pa dyshim që deri tani Shqipëria paraqet një nivel të favorshëm të borxhit të jashtëm, por huamarrja e ardhshme duhet të jetë më e kujdesshme dhe ka nevojë për analiza të rëndësishme mbi kosto-përfitim. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare së bashku me Bankën Qendrore, duhet të fillojë përgatitjen për një vlerësim të klasifikimit të kredisë. Kjo duhet të zhvillohet në mënyrë transparente për të vendosur mbi kohën e përshtatshme. Për shkak të mungesës së përvojës, një hap tjetër që duhet ndërmarrë është trajnimi i personelit mbi tregjet financiare ndërkombëtare.

LITERATURË

Albania: Sustaining Growth Beyond the Transition. A World Bank Country Economic Memorandum, 2004.

Albania - Supplementary Memorandum on Economic and Financial Policies, Technical Memorandum of Understanding, IMF, February 03, 2005.

Raporti Vjetor 2004. Banka e Shqipërisë.

A. Michael Andrews, (2005), "State-Owned Banks, Stability, Privatization, and Growth: Practical Policy Decisions in a World Without Empirical Proof", IMF Working Paper.

Cani, Sh. dhe Hadëri, S (2003), "Sistemi financiar shqiptar në tranzicion: Progres apo brishtësi?", Banka e Shqipërisë.

Programi Afatmesëm Buxhetor (Medium Term Budget Program) 2005-2007, Ministria e Financave.

Wojciech S Maliszewski (2000), "Central bank independence in transition economies" Economics of Transition, 8 (3), 749-789.

SHËNIME

* Sulo Hadëri: profesor në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

** Sybi Hida: Master në ekonomi, është Këshilltar i Ministrit të Financave.

¹ Ai ka përdorur tregues të ngjashëm me disa ndryshime, për matjen e shkallës së pavarësisë së një banke qendrore, me ato të propozuar nga Grilli, Masciandaro dhe Tabellini (GMT) (1991).

